

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ...., datë .....2019

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË SHPALLJES SË  
“KURORËS SË GJELBËR” DHE PËRCAKTIMI I RREGULLAVE DHE I  
PËRGJEGJËSIVE NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN, MBROJTJEN DHE  
RUAJTJEN E KURORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 23 të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e kriterëve dhe procedurave të shpalljes së kurorës së gjelbër dhe përcaktimin e rregullave dhe përgjegjësisve në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës së gjelbër.

2. “Kurora e gjelbër” përbëhet nga territore ose zona relativisht të vogla, në zonat periferike urbane, që përfshin pjesë tokë si sipërfaqe pyjore apo tokë me bimësi pyjore, pemtore, ullishte, rezervuarë apo trupa të tjerë ujorë si pjesë e sipërfaqeve të mësipërme, të destinuara për shplodhjen, argëtimin, për aktivitet ndërgjegjësuë dhe edukuese për publikun, turistët, apo individë të ndryshëm.

3. Territori që përbën kurorën e gjelbër është pronë e bashkisë dhe është pjesë e planit të përgjithshëm vendor të bashkisë.

II. KRITERET DHE PROCEDURAT E SHPALLJES SË KURORËS SË GJELBËR

4. Plotësojnë kriteret që të shpallen “Kurorë e gjelbër” ato sipërfaqe, të përmendura në pikën 2, që:

- a) kanë një sipërfaqe që nuk kalon 20 % e sipërfaqes së gjelbër të bashkisë;
- b) nuk janë përfshirë në rrejtin ekzistues kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore;
- c) kanë një zhvillim pyjor, pemtor apo të ullishteve, të konsideruar, që plotësojnë masën e gjelbërt të qyteteve;

- d) janë të populluar me floje të florës dhe faunë, kryesisht të karakterit lokal;
- e) sigurojnë ruajtjen dhe konservimin e mjedisit natyror dhe vlerave të biodiversitetit;
- f) janë kryesisht zona natyrore, të pyllëzuara ose të kultivuara ku mund të kryhen veprimtari të ndryshme rekreative;
- g) nxisin ruajtjen e mjedisit, të peizazhit dhe mirëmbajten e integritetit ekologjik;
- gj) krijojnë premisa për përfitime në përtëritjen e shëndetit të njeriut, të vizitorëve dhe heqjen e stresit të jetës urbane;
- h) ofrojnë mundësi për komunitetin për shlodhje, për veprimtari shoqërore, tradicionale, edukative, argëtuese, sportive, kulturore, turistike, zbavitje familjare, marrjen e ajrit të pastër, shëtitje në natyrë;
- i) krijojnë mundësi edukimi, ndërgjegjësimi, informimi dhe vlerësimi për të gjithë kategoritë dhe moshat e shoqërisë;
5. Procesi i shpalljes së një kurore të gjelbër inicohet nga ana e pushtetit vendor kur janë siguruar burimet financiare dhe njerëzoro-profesionale për këtë qëllim.
6. Procesi i shpalljes "Kurore e gjelbër" paraprihet nga propozimi që ka këto hapa:
- a) hartohet, brenda një periudhe gjashtë mujore nga ndërmarrja e inicativës për shpalljen e zonës "Kurore e gjelbër", propozimi për sipërfaqen që planifikohet të shpallet kurore e gjelbër, nëpërmjet bashkëpunimit të strukturave përkatëse të bashkisë me organet shtetërore vendore të interesuara, me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), shoqatat mjedisore vendore, institucionet kërkimore-shkencore dhe palë të tjera të interesuara;
- b) propozimi duhet të përmbajë të dhëna për territorin që synohet të shpallet, vendndodhjen, kufijtë dhe objektivat e administrimit dhe zhvillimit të synuar;
- c) propozimi duhet të hartohet në përputhje me strategjitë sektoriale të veprimtarive që parashikohet të zhvillohen, planet e veprimit e programet e zhvillimit të bashkisë, në mbështetje të planit vendor dhe kërkesave të Dokumentit Strategjik të Politikave për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri;
- d) propozimi publikohet dhe qëndron i publikuar për një periudhë dymujore në qendër të bashkisë, në një vend të dukshëm, për të cilin komuniteti, bizneset, OJF-të dhe të interesuarit, bëjnë vërejtje e sugjerime të cilat i paraqiten Kryetarit të bashkisë.
- e) me përfundimin e këtij afati, duke marrë në konsideratë për aq sa është e mundur sugjerimet dhe komentet e bëra, bashkia nëpërmjet një grupi pune fillon përgatitjen e studimit, mbi bazën e të cilit do të realizohen procedurat për shpalljen e kurores së gjelbër.
7. Studimi mbi bazën e të cilit do të realizohen procedurat për shpalljen e kurores së gjelbër, realizohet brenda një periudhe gjashtë mujore nga një grup pune me përbërje të ekspertëve të fushave kryesore të OJF-ve, si dhe me përfaqësues të AdZM dhe ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Përbërja e grupit të punës dhe drejtuesi i tij, miratohen nga këshilli i bashkisë, me propozim të kryetarit të bashkisë.
8. Studimi i kryer nga grupi i punës duhet të mbështetet dhe të përfshijë sa më poshtë:
- a) të grumbullojë informacionin e nevojshëm, duke bashkëpunuar në vazhdimësi me strukturat bashkiake të institucioneve qendrore, administratën rajonale të zonave të mbrojtura (AdRZM), me banorët, shoqatat mjedisore dhe rrethet shkollore, shkencore apo akademike;

- b) të shqyrtojë planin vendor të zhvillimit të territorit, strategjitë sektoriale që parashikohen të zhvillohen, planet e veprimit dhe programet e zhvillimit të bashkisë së dhe Dokumentin Strategjik të Politikave për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri;
- c) të ndërmarrë vëzhgime në terren, të cilat do të ndihmojnë në analizat e nevojshme për studimin e zonës mjedisore, të biodiversitetit e peizazhit, mjedisit në tërësi apo infrastrukturës, si dhe të modeleve të përgjithshme të zhvillimit social-ekonomik, turistik, etj.
- d) të argumentojë krijimin e "Kurorës së gjelbër", të propozojë emrin e kurorës, si dhe objektivat e ruajtjes, administrimit dhe menaxhimit të saj;
- e) të paraqesë rezultatet e procesit të këshillimit me komunitetin dhe grupet e interesuara, duke përfshirë komentet e bëra dhe reflektimin e propozimeve;
- f) të paraqesë sipërfaqen e përgjithshme dhe kufijtë e zonës së propozuar "Kurorë e gjelbër", të bëjë përshkrimin fizik dhe biologjik të sipërfaqes së propozuar dhe ndarjen sipas mbulesës së tokës;
- g) të paraqesë rëndësinë e habitateve, ekosistemeve, llojeve floristike e faunistike, vlerave historike, kulturore, arkeologjike, monumenteve dhe zonave ekoturistike;
- gj) të bëjë përshkrimin e masave dhe investimeve që do të bëhen për mirëmbajtjen e "Kurorës së gjelbër";
- h) të paraqesë hartën dixhitale të sipërfaqes që do propozohet "Kurorë e gjelbër".

9. Pas përfundimit të studimit dhe mbi bazën e tij, brenda dy muajve nga përfundimi i tij, përgatitet nga strukturat përkatëse të bashkisë projektvendimi i Këshillit Bashkiak, që propozon shpalljen "Kurorë e gjelbër", i cili shqyrtohet në mbledhjen e rradhës së këtij Këshilli.

10. Projektvendimi duhet të përmbajë emërtimin e "Kurorës së gjelbër", sipërfaqen e përgjithshme, kufijtë dhe hartën e dixhitalizuar, si dhe objektivat e ruajtjes, administrimit dhe menaxhimit të saj.

11. Studimi i kryer bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e projektvendimit.

12. Në rast të miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, vendimi që propozon shpalljen e "Kurorës së gjelbër", brenda 30 ditëve nga miratimi i dërgohet Këshillit Kombëtar të Territorit për shqyrtim dhe miratim.

13. "Kurora e gjelbër" shpallet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.

14. Mbas shpalljes së "Kurorës së gjelbër" fillon procedura e hartimit të planit të menaxhimit, që realizohet në përputhje me kërkesat e ligjit "Për zonat e mbrojtura". Plani i menaxhimit të kurorës së gjelbër miratohet me urdhër të ministrit që drejton ministrinë përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore.

### III. RREGULLAT DHE PËRGJEGJËSITË LIDHUR ME ADMINISTRIMIN, MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E KURORËS

15. Organi përgjegjës lokal për vendimarrjet për kurorën e gjelbërt, është këshilli bashkiak dhe për administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e saj është administrata e "Kurorës së gjelbër".

16. Administrata e "Kurorës së gjelbër" krijohet si një strukturë me jo më shumë se tre persona, me personel të përzgjedhur nga strukturat aktuale të bashkisë, që drejtohet nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

17. Administrata e "Kurorës së gjelbër" ligjohet me propozimin të kryetarit të bashkisë dhe vendim të Këshillit Bashkiak, pas shpalljes së "Kurorës së gjelbër".

18. Administrata e Kurorës së gjelbër përgjigjet për administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës dhe ka detyrë të saj parësore zbatimin e planit të menaxhimit të kurorës së gjelbër.

19. Krahas kësaj, administrata e kurorës së gjelbër luyen dhe detyra të tjera, si:

- a) përcakton vendet e vendosjes në terren të shenjave kufizuese për të bërë kështu shënimin e kufirit të kurorës së gjelbër;
- b) përcakton formën e sinjalistikës së kurorës dhe vendet e vendosjes së tabelave dhe shenjave treguese dhe të shtigjeve të kalimit për vizitorët;
- c) bën planifikimet e nevojshme lidhur me:
  - i. infrastrukturën e nevojshme në shërbim të vizitorëve të kurorës së gjelbër si stola, belvedere, çezma dhe shtigje të ndryshme;
  - ii. infrastrukturën për ngritjen e strukturave të shërbimeve shëndetësore e të nyjeve sanitare dhe atyre të shërbimeve të tjera për vizitorët;
  - iii. zonat e veçanta për argëtim dhe veprimtari sportive;
  - iv. zonat e kufizuara për parkimin e mjeteve të ndryshme;
  - v. masat për rigjallërimin e pyjeve, të ripyllëzimit me lloje vendase dhe dekorative, në përputhje me funksionet e kurorës së gjelbër;
- d) nuk lejon kryerjen e çfarëdolloj ndërhyrjeje dhe veprimtarie në kurorë që nuk është në përputhje me parashikimet e planit të menaxhimit;
- e) merr masat e nevojshme për pezullimin apo kufizimin e të gjitha veprimtarive që çënojnë qëllimin dhe objektivat e menaxhimit;
- f) organizon kontrollet që evidentojnë gjendjen reale të kurorës gjelbër;
- g) në raste kundërvajtjesh, sugjeron penalizime në përputhje me kërkesat e legjislacionit;
- gj) mban dhe plotëson regjistrin/skedarin e kurorës së gjelbër;
- h) dokumenton veprimtaritë, investimet, kërkimet shkencore të kryera;
- i) organizon, në bashkëpunim me strukturat të tjera veprimtari ndërgjegjësuese për të bërë të njohura vlerat e kurorës gjelbër;
- j) bashkërendon veprimtari me palët e treta, si shoqatat mjedisore, biznesin, vizitorët, kërkuesit shkencorë, privatët, etj.
- k) mbikqyr edhe objektet kulturore, historike, arkitektonike dhe arkeologjike që ndodhen brenda kurorës gjelbër, etj.

20. Të gjithë detyrat dhe rregullat për administratën e kurorës së gjelbër, të paraqitura më lart, përfshihen në "Rregulloren e administrimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së kurorës së gjelbër", që hartohet nga strukturat e bashkisë dhe miratohet në Këshillin Bashkiak, jo më vonë se tetë muaj nga shpallja e kurorës së gjelbër.

21. Për veprimtarinë e saj lidhur me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës së gjelbër, administrata e "Kurorës së gjelbër" raporton rregullisht, por jo më pak se një herë në vit, përpara kryetarit të bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

22. Administrata e "kurorës së gjelbër" lidhur me veprimtarinë e saj dhe mbarëvajtjen e "kurorës së gjelbër" bashkëpunon vazhdimisht me Drejtorinë rajonale të Zonave të Mbrojtura. Administrata e kurorës së gjelbër informon jo më pak se dy herë në vit ministrinë përgjegjëse

për mjedisin dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me raporte mbi ecimin e administrimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së Kurore të gjelbra.

23. Ngarkohen njësitë e vetqeverisjes vendore, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

RELACION  
PËR  
PROJEKTVENDIMIN  
PËR  
MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË  
SHPALLJES SË “KURORËS SË GJELBËR” DHE PËRCAKTIMI  
I RREGULLAVE DHE I PËRGJEGJËSIVE NË LIDHJE ME  
ADMINISTRIMIN, MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E KURORËS

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË  
ARRIHEN

Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të shpalljes së “Kurorës së gjelbër” dhe përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësive në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës” ka si qëllim që në përputhje dhe në zbatim të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, të hartojë dhe miratojë kriteret dhe procedurat për shpalljen e zonës së mbrojtur mjedisore “Kurorë e gjelbër”, sikurse të përcaktojë edhe rregullat dhe përgjegjësitë në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës.

Seksioni IV i ligjit të mësipërm 81/2017 paraqet të gjithë zonat e mbrojtura mjedisore me interes kombëtar, ndërsa neni 23 shprehet në mënyrë të posacme për zonën e mbrojtur “Kurorë e gjelbër”.

Projektvendimi i propozuar është hartuar në zbatim të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Objektivi është që të bëhet sa më i plotë kuadri ligjor dhe nënligjor kombëtar, jo vetëm për zonat e mbrojtura por dhe për mbrojtjen e natyrës në tërësi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim dhe miratim bën pjesë në matricën analitike të projektakteve për vitin 2019. Ai është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke kontribuar për shtimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura. Miratimi i këtij projektvendimi kontribon gjithashtu në zbatimin e

masave të parashtuara në Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit deri në vitin 2020 për Shqipërinë.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi synon të hartojë kritere dhe procedura për shpalljen e njëres prej kategorive të zonave të mbrojtura mjedisore - kurorës së gjelbër, sikurse dhe të përcaktojë rregullat lidhur me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e saj.

Konkretisht, projektvendimi formulon hapat që duhen ndërmarrë nga strukturat e bashkive që duan të propozojnë kurora të gjelbërta në territorin e tyre, duke bashkëpunuar për këtë me Ministrinë Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe palë të interesuara.

Me miratimin e këtij projektvendimi krijohen premiset për shtimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura të vendit.

### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën dhe me kuadrin ligjor kombëtar të fushës së mbrojtjes së natyrës dhe zonave të mbrojtura dhe hartohet në zbatim të nenit 23, pika 3 të ligjit nr. 81/2017, "Për Zonat e Mbrojtura".

### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është konceptuar në tre Krerë me 23 pika gjithsej.

Kreun I përmban parashikime të përgjithshme. Konkretisht, pika 1 e projektvendimit konsiston në pjesën hyrëse që formulon dispozitën për miratimin e kritereve dhe procedurave të shpalljes së "Kurorës së gjelbër" dhe përcaktimin e rregullave dhe përgjegjësive në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës së gjelbër.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e kritereve dhe procedurave të shpalljes së "Kurorës së gjelbër" dhe përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësive në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës"

Pikat 2 dhe 3, saktësojnë territorin që përfshihen në "Kurorën e gjelbër" dhe llojin e pronësisë së këtij territori.

Në Kreun II, parashikohen kriteret dhe procedurat për shpalljen e kurorës së gjelbër.

Konkretisht, në pikën 4 përcaktohen kriteret që duhet të plotësojë një sipërfaqe, në mënyrë që të mund të shpallet kurorë e gjelbër, ndërsa në pikën 5 përcaktohen kushtet kur procesi i shpalljes mund të iniciohet nga Bashkia.

Pika 6, konsiston në parashikimin e hapave që përbëjnë propozimin për shpalljen e kurorës si: (i) kohën që duhet të marrë ky propozim, (ii) strukturat që do marrin pjesë në hartimin e propozimit, (iii) të dhëna mbi territorin që synohet të shpallet, të tilla si vendndodhja, kufijtë dhe objektivat e administrimit dhe zhvillimit të synuar, (iv) kohën prej dy muajsh që propozimi qëndron i ekspozuar për sugjerime e komente të mundëshme e deri fillimin e përgatitjes së studimit për shpalljen e kurorës së gjelbër.

Pikat 7 dhe 8 paraqesin përbërjen e grupit të punës që do përgatisë studimin për shpalljen e kurorës së gjelbër, kohën prej 6 (gjashtë) muajsh të nevojshme për këtë studim, si dhe hapat që duhet të përfshijë studimi.

Nëpërmjet pikave 9, 10 dhe 11 përcaktohen hapat që studimi i përfunduar kalon më tej: paraqitjen brenda dy muajve për miratim në Këshillin Bashkiak të propozimit për shpalljen "Kurorë e gjelbër", elementë që duhet të përmbajë projektvendimi, si dhe faktin që studimi është pjesë përbërëse e projektvendimit.

Ndërsa, në pikat 12 deri 13 parashikohen hapat që kalon procesi deri në shpalljen e "Kurorës së gjelbër" me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Më tej, në pikën 14, shprehet detyrimi për hartimin dhe miratimin e planit të menaxhimit për këtë zonë të re të mbrojtur.

Në Kreun III, paraqiten rregullat dhe përgjegjësitë lidhur me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës së gjelbër.

Nëpërmjet pikave 15, 16 dhe 17 parashikohet ngritja e administratës së "Kurorës së gjelbër" si struktura përgjegjëse për administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës – një strukturë prej jo më shumë se tre personash, përzgjedhur nga strukturat aktuale, që ngrihet me propozim të kryetarit të bashkisë dhe vendim të Këshillit Bashkiak.

Pikat 18, 19 dhe 20 përcaktojnë përgjegjësitë që ka dhe detyrat që mbulon administrata e kurorës së gjelbër, duke filluar me zbatimin e planit të menaxhimit e deri në zbatimin e rregullores së veprimtarisë së administrimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së kurorës së gjelbër.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të shpalljes së "Kurorës së gjelbër" dhe përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësisë në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës"



Ndërsa në pikat 21 dhe 22 japen strukturat shpërndarë, në nivel lokal dhe qendror, tek të cilat raporton dhe dërgon informacion administrata e kurorës së gjelbër dhe, në pikën 23 dhe të fundit, parashikohen strukturat e ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi, të cilat janë njësitë e vetqeverisjes vendore, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

#### VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe njësitë e vetqeverisjes vendore.

#### VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

#### IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Blendi KLOSI